

Data e njoftimit për KPK:

18.12.2024

Shpallja e KPK: 18.12.2024



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë ("Ligji për Energjinë e Ripërtërishme"), Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2024 për Procesin e Ofertimit Konkurrues ("UA për Procesin e Ofertimit Konkurrues"), dhe Vendimin e Ministrisë së Ekonomisë me numër 6929 për fillimin e Procesit të Ofertimit Konkurrues për projektin e erës, Ministria e Ekonomisë lëshon këtë:

NJOFTIM / NJOFTIM PËR KONTRATË

Procesi i Ofertimit Konkurrues/Nr. i Brendshëm: 02-002-2024

- Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktues:**
Ministria e Ekonomisë, Republika e Kosovës
Adresa: Sheshi Zahir Pajaziti, Nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
- Emri dhe detajet e kontaktit të personit të kontaktit:**
Z. Armend Krasniqi Njësia për Implementim të Projekteve nga BRE, Ministria e Ekonomisë
E-mail: armend.r.krasniqi@rks-gov.net
Telefoni: +3833820021565
- Titulli i kontratës i dhënë nga Autoriteti Kontraktues**
Procesi i Ofertimit Konkurrues për Projektin e Erës me Kapacitet të Synuar mes 50 dhe 100 MW duke përfituar nga Skema Mbështetëse
- Forma, objekti dhe lloji i kontratës:**
Kontrata e miratuar mbështetëse është Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike, e cila do të konvertohet në Kontratë për Diferencë ("Marrëveshja MBE/KpD") me plotësimin e kushteve të

parapara me nenin 12 të Ligjit për Promovimin e përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë

Dhënia e një çmimi të garantuar të blerjes do të zbatohet për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti i erës me kapacitet të synuar ndërmjet 50 dhe 100 MW, bazuar në ofertën e Ofertuesit të Suksesshëm në Procesin e Ofertimit Konkurrues. Çmimi i blerjes i përfshirë në ofertat e Ofertuesve të Kualifikuar nuk do të tejkaloj çmimin maksimal të përcaktuar nga ZRRE-ja, në përputhje me nenin 11, paragrafi 6 të Ligjit për Promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të Energjisë. Sipas Vendimit të ZRRE], çmimi maksimal i garantuar i blerjes për MWh për këtë Proces Ofertimi Konkurrues do të jetë [80.20 EUR].

Dhënia do të rezultojë në nënshkrimin e një pako të Marrëveshjeve të Projektit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit ("MZhP"), Marrëveshjen për Kyçje, Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë, dhe Marrëveshjen për Inxhinier të Pavarur, në lidhje me projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe detyrat e dekomisionimit të impiantit të erës sikurse specifikohet në Dokumentacionin e Ofertimit.

5 Lloji i Procesit të Ofertimit Konkurrues:

Procesi i Ofertimit të Konkurrues është me dy (2) faza që përbëhet nga:

- Kërkesa për Kualifikim – me afat të paktën 60 ditë;
- Kërkesa për Propozim – me afat të paktën 60 ditë.

6 Lokacioni i projektit:

Impianti i erës do të ndërtohet në një lokacion të propozuar nga Ofertuesi i Suksesshëm.

7 Afati kohor për zbatimin e projektit:

Ofertuesi i Suksesshëm do të projektojë, ndërtojë, instalojë, operojë, mirëmbajë dhe dekomisionoj impiantin e erës, sipas afatit kohor të përcaktuar në MZhP me Ministrinë e Ekonomisë.

8 Marrëveshja MBE/KpD:

Ofertuesi i Suksesshëm do të lidhë një Marrëveshje MBE/KpD me Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme, të caktuar nga Qeveria në rastin konkret KOSTT Sh.A., Operator i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut të Republikës së Kosovës, në bazë të Vendimit Nr. 08/236, i datës 11.12.2024, për një afat prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh duke filluar nga data e funksionalizimit të impiantit të erës..

Ofertuesi i Suksesshëm dhe entiteti për qëllime të posaçme të regjistruar për projektin, në cilësinë e zhvilluesit të projektit, do të lidhin gjithashtu një MZhP me Ministrinë e Ekonomisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, për qëllime të zhvillimit të projektit të erës për kapacitetin total të ofruar gjatë Procesit të Ofertimit Konkurrues.

Draftet e MBE/KpD dhe MZhP do të sigurohen me Kërkesën për Propozim në Dhomën e të Dhënave të Projektit.

9 Afati tentativ për dorëzimin e Kërkesës për Kualifikim:

20 shkurt 2025, ora 12:00 (CET).

10 Afati tentativ për dorëzimin e Kërkesës për Propozime:

20 shtator 2025, ora 12.00 (CET).

11 Periudha e vlefshmërisë së ofertës:

Ofertat duhet të jenë të vlefshme për njëqind e tetëdhjetë (180) ditë, përveç nëse parashikohet ndryshe ose ndryshohet me publikimin e Kërkesës për Propozime, e llogaritur në datën e caktuar si afat për dorëzimet për Kërkesën për Propozime ("Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës").

12 Garancia e ofertës:

Një garanci e ofertës, në formën e një letër krediti të formës së paravokueshme, të pakushtëzuar, sipas kërkesës, sikurse specifikohet në Dokumentacionin e Ofertimit, që do të jetë e vlefshme gjatë Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës me mundësinë e zgjatjes edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera (pa cenuar dispozitat e parashtruara në Kërkesën për Propozime).

13 Procedura për qasje në Dokumentet e Ofertimit:

Informacioni mbi Kërkesën për Kualifikim do të jetë publikisht i qasshëm në uebfaqen e BRE-ve <https://reskosovo.rks-gov.net/>.

14 Kërkesat e pranueshmërisë dhe kriteret e dhënies:

Ofertuesit e Mundshëm duhet të përmbushin kriteret e pranueshmërisë dhe kualifikimit minimal që kanë të bëjnë me kërkesat teknike, profesionale, ekonomike, financiare, dhe kërkesat e performancës mjedisore dhe sociale (M dhe S), dhe kërkesa të tjera sikurse parashikohen në Kërkesën për Kualifikim dhe Kërkesën për Propozime.

Marrëveshjet e Projektit do t'i jepen Ofertuesit të Suksesshëm që ka ofruar çmim më të ulët të garantuar të blerjes për MWh për energjinë e liferuar, të shprehur në EUR/MWh, pa TVSh, me kusht që çmimi i tillë të mos e kalojë çmimin maksimal të përcaktuar nga ZRRE, në përputhje me nenin 11, paragrafi 6 të Ligjit për Energjinë e Ripërtërishme.

Detaje të mëtejshme mund të merren nga uebfaqja e BRE: <https://reskosovo.rks-gov.net/>